



Prishtinë, 06 shtator 2013
Kodi i ZRRE-së: V_555_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, Nenin 25, Nenin 27, Nenin 30 dhe Nenin 34 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 38 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L-201);
- Dispozitat e Nenit 2, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 dhe Nenit 34 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë
- Kërkesën për ndryshim/modifikim të licencave për gjenerim të energjisë elektrike për TC Kosova A dhe TC Kosova B, e datës 28.06.2013 të ndërmarrjes Korporata Energjetike e Kosovës, adresa: rruga "Nënë Tereza" nr. 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës;

në seancën e mbajtur me datë 06 shtator 2013, nxori këtë:

VENDIM

NDRYSHOHET licenca për prodhim të energjisë elektrike (KREU I) e dhënë Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH.A.), Divizioni i Gjenerimit "TC Kosova B", me numër licence ZRRE/Li_05/12_B. Të gjitha dispozitat tjera të Licencës mbesin në fuqi.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 28.06.2013 ka pranuar nga KEK SH.A Kërkesën për ndryshim/modifikim të licencave për prodhim të energjisë elektrike të KEK Sh.a. për TC Kosova A dhe TC Kosova B, të bërë në pajtim me Nenin 38 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L-201).
 - ZRRE ka ndryshuar/modifikuar KREUN I të licencës për prodhim të energjisë elektrike të KEK SH.A-së "TC Kosova B", duke i lejuar të licencuarit që të importojë energji elektrike të nevojshme për plotësimin e nevojave të konsumatorëve të pakualifikuar, në periudha kohore kur prodhimi vendor është i pamjaftueshëm, dhe kur në mungesë të këtyre importeve, konsumatorët do t'i nënshtrohen shqyçjes. Ky obligim do të shfuqizohet në pajtim me Nenin 38, paragrafin 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
 - ZRRE duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- I. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.**



II. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bashkëngjitur Licenca e Modifikuar*

Vendimi i dërgohet:

- Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH.A)
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar